



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 95/3 prot.

Tiranë, më 07.02.2020

VENDIM

Nr. 09, datë 07.02.2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 02, DATË 21.01.2020, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Bashkisë Fier.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Fier, e cila ka raportuar nëpërmjet shkresës nr. 6845/1 prot., datë 02.09.2019, se punonjësi ***** me detyrë “Drejtor”, plotëson moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 06.12.2019.

Mbi këtë bazë, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 02, datë 21.01.2020, ka vendosur:

- “1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Fier marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin ***** në pozicionin “Drejtor”.
2. Pozicioni respektiv i punës, të shpallet menjëherë si pozicion i lirë dhe të fillojë procedura për plotësimin e tij sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim ...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 02, datë 21.01.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Fier, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, institucioni i Bashkisë Fier përmes shkresës së dërguar me nr. 548/1 prot., datë 03.02.2020, me objekt: “Kërkesë për bashkëpunim”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 95/2 prot., datë 06.02.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësin e përmendur në vendimin paralajmërues, për shkak të mospërfundimit të procedurës së konkurrimit, si rrjedhojë e mungesës së interesit nga kandidatët dhe mosplotësimin të kërkesave të veçanta të pozicionit të punës.

Në të njëjtën kohë, në shkresën e mësipërme është argumentuar domosdoshmëria e funksionimit të pandërprerë të këtij pozicioni pune, për shkak se në Drejtorinë e Projektiveve, që drejtohet nga nëpunësi ***** , hartohen projektet dhe ndiqet zbatimi i tyre për gjithë investimet e reja apo rikonstruktionet, në Bashkinë Fier.

Në analizë të sa më lart kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës për punonjësin ***** , do të sillte pengesa në realizimin e projekteve të investimit apo rikonstruktionit, si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit të Bashkisë Fier, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 02, datë 21.01.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Fier, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, nga ana e institucionit Bashkia Fier është e drejtë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kreu IV “Rishikimi”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 02, datë 21.01.2020, me përmbajtje si më poshtë:

Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësin *****, me detyrë “*Drejtor i Drejtorisë së Projektmeve*”, në Bashkinë Fier, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e këtij pozicioni pune.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Fier dhe Njësia Përgjegjëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha